REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 473/26 Dt. 09.10.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b), të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Rregullores (QRK) për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, e bazuar në ftesën e GIZ-it, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Përparim Shalës, zyrtar publik në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, për në Podgoricë të Republikës së Malit të Zi, me qëllim të pjesëmarrjes në trajnim/punëtorinë me temën: "Modulin III të Akademisë së Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban Rezistues ndaj Klimës" e cila do të mbahet nga data 13 tetor 2026 deri me 16 tetor 2026, kështu që, për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve për të lartcekurin, konform akteve ligjore për udhëtimet zyrtare.

2. Shuma e lejuar, e përshkruar në këtë Vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës - pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit dhe Komunës dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

3. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Të lartcekurit,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 480/26 Dt. 16.10.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Rregullores (QRK) nr. 06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bazuar në ftesën e Ambasadës së Republikës së Kosovës në Izrael, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Kreshnik Krasniqit-zyrtar publik në DKRS, për pjesëmarrje në aktivitetet/takimet sportive, edukative, kulturore, etj., të cilat do të mbahet nga data 16 tetor 2026 deri me 22 tetor 2026, në shtetin e Izraelit, kështu që, për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar, pagesa e mëditjeve, si dhe mbulimi i shpenzimeve të paparashikuara për të lartcekurin, konform akteve ligjore për udhëtimet zyrtare.

2. Kjo vizitë studimore financohet nga Ministria për Bashkëpunim Rajonal e Shtetit të Izraelit në kordinim me Ambasadën e Republikës së Kosovës në Izrael.

3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës - pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit dhe Komunës dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

4. Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Të lartcekurit,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 481/26 Dt. 19.10.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Rregullores (QRK) nr. 06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Florent Ukaj-drejtor i DUPH dhe Zana Belloda- bashkëpunëtore profesionale në DUPH, për pjesëmarrje në Vizitën Studimore me përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, AKM dhe Komunave, e cila do të mbahet nga data 20 tetor 2026 deri me 24 tetor 2026, në Lubljanë të Republikës së Sllovenisë, kështu që, për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar, pagesa e mëditjeve, si dhe mbulimi i shpenzimeve të paparashikuara për të lartcekurit, konform akteve ligjore për udhëtimet zyrtare.

2. Kjo vizitë studimore organizohet në bashkëpunim me Asociacionin e Komunave të Kosovës me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë dhe GIZ-it, përmes projektit Kosovo for Green (K4G) të bashkëfinancuar nga Sekretariati Shtetëror Zvizerian për Çështje Ekonomike (SECO) dhe Ministria Federale Gjermane për bashkëpunim ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).

3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës - pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit dhe Komunës dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

4. Obligohet Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Të lartcekurve,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 484/26 Dt. 21.10.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 paragrafi f dhe g, të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Kontratës për qiranë e tokës të nënshkruar ndërmjet Komunës së Prizrenit dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural- Agjencia Pyjore e Kosovës 01 nr. 166/22, të datës 29.09.2022, dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për lejimin e mjeteve financiare

1. Lejohen mjetet financiare për pagesë të qirasë, e cila pagës është e bazuar në nenin 4 të Kontratës për qiranë e tokës të nënshkruar ndërmjet Komunës së Prizrenit dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural- Agjencia Pyjore e Kosovës 01 nr. 166/22, të datës 29.09.2022, kështu që, për këtë qëllim dhe në emër të pagesës së ratës së tretë, përkatësisht pagesës vjetore (faturës) për periudhën 24.08.2025-24.08.2026 lejohen mjetet financiare në shumë prej 4.606.80 € (katërmijë e gjashtëqind e gjashtë euro e tetëdhjetë cent).

2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Kontrata për qiranë e tokës e nënshkruar ndërmjet Komunës së Prizrenit dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural- Agjencia Pyjore e Kosovës 01 nr. 166/22, të datës 29.09.2022.

3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i mallrave dhe shërbimeve dhe subvencioneve dhe transfereve i Zyrës së Kryetarit të Komunës.

4. Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- MBPZHR-Agjencia Pyjore e Kosovës,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 483/26 Dt. 21.10.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), Vendimit 001-011 nr. 66126, të datës 02.06.2026 të Kuvendit të Komunës së Prizrenit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR ADMINISTRTIMIN DHE PROCEDIMIN E DOKUMENTACIONIT LIDHUR ME SUBVENCIONIMIN E TRANSPORTIT URBAN

1. Selver Osmanaj-zyrtar në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, caktohet zyrtar përgjegjës për administrimin dhe procedimin e dokumentacionit lidhur me subvencionimin e transportit urban në Komunën e Prizrenit.

2. Detyrat e personit përgjegjës janë:
   2.1. Të pranoj dhe kontrolloj faturat dhe dokumentacionin përcjellës të dorëzuar nga operatori,
   2.2. Të verifikoj përputhjen e faturave me kushtet dhe obligimet e përcaktuara në shpallje,
   2.3. Të kontrolloj raportet periodike të operatorit dhe dokumentacionin që dëshmon realizimin e shërbimit,
   2.4. Të verifikoj të dhënat relevante për llogaritjen e subvencionit në pajtim me metodologjinë dhe kriteret e përcaktuara në shpallje,
   2.5. Të evidentoj çdo mospërputhje ose mungesë të dokumentacionit dhe të kërkoj nga operatori plotësimin dhe korrigjimin e tij,
   2.6. Pas verifikimit të dokumentacionit, të përgatisë dhe procedoj dokumentacionin e nevojshëm për pagesë në njësinë kompetente të Komunës,
   2.7. Të mbaj evidencë të faturave, raporteve, dokumenteve përcjellëse dhe pagesave të proceduara,
   2.8. Të bashkëpunoj me Drejtoritë përkatëse, Drejtorinë për Ekonomi dhe Financa dhe njësit tjera kompetente për çështjet që lidhen me realizimin e subvencionit,
   2.9. Të raportoj te drejtori i DSHP-së lidhur me gjendjen e dokumentacionit, faturat e pranuara, faturat e proceduara dhe çështjet eventuale që pengojnë procedimin e pagesave,
   2.10. Të kryej edhe detyra të tjera që lidhen me administrimin dhe procedimin e subvencionimit të transportit urban, sipas udhëzimeve të Drejtorisë dhe akteve përkatëse.

3. Me këtë vendim anulohet Vendimi 01 nr. 463/26, i datës 29.09.2026.

4. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

5. Obligohet zyrtari i lartcekur, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe organet tjera kompetente, për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



➢ Vendimi iu dërgohet:
- Të lartcekurit,
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
- Organeve tjera kompetente,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 486/26 Dt. 21.10.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 paragrafi g, të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të nenit 25 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Metodologjisë së Planit të Integritetit të miratuar me vendim nr. 1459/26, të datës 19.08.2026, të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
PËR EMËRIMIN E KOORDINATORIT PËR PLANIN E INTEGRITETIT PËR KOMUNËN E PRIZRENIT PËR PERIUDHËN 2027-2029

1. Edona Hashani- zyrtare ligjore në Komunën e Prizrenit, emërohet koordinatore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit për Integritet për Komunën e Prizrenit për periudhën 2027-2029.

2. Detyrat kryesore të koordinatores janë:
   2.1. Organizon dhe koordinon punën e Grupit Punues,
   2.2. Siguron komunikim ndërmjet njësive organizative gjatë procesit të identifikimit të rreziqeve,
   2.3. Mbledh dhe sistematizon informacionet dhe dokumentacionin relevant,
   2.4. Mbikëqyr procesin e identifikimit dhe vlerësimit të rreziqeve të integritetit,
   2.5. Përgatit draftin e Planit të Integritetit në bashkëpunim me Grupin Punues,
   2.6. Koordinon procesin e konsultimit të draftit të planit,
   2.7. Mbështet procesin e monitorimit dhe raportimit për zbatimin e Planit.

3. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

4. Obligohet zyrtarja e lartcekur dhe Grupi Punues për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Të lartcekurës,
- Organeve tjera kompetente,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 485/26 Dt. 21.10.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 paragrafi g, të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të nenit 25 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Metodologjisë së Planit të Integritetit, të miratuar me Vendim nr. 1459/26, të datës 19.08.2026, të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT PËR KOMUNËN E PRIZRENIT

1. Me këtë vendim fillon procesi për hartimin e Planit të Integritetit për Komunën e Prizrenit për periudhën 2027-2029.

2. Formohet dhe emërohet Grupi Punues për hartimin e Planit të Integritetit për Komunën e Prizrenit për periudhën 2027-2029. Anëtarë të këtij Grupi Punues emërohen:

   2.1. Shpend Berisha,.....Njësia e Auditimit të Brendshëm,
   2.2. Visar Islamaj,.....Sektori i Prokurimit,
   2.3. Liridona Hasani.....Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore,
   2.4. Adelina Hoxhaj.....Zyra për Informim,
   2.5. Bashkim Rakaj, ...Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale,
   2.6. Sherife Çengaj, ...Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik,
   2.7. Almir Saiti,.....Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës,
   2.8. Agnesa Kurejshi,.....Drejtoria e Shërbimeve Publike,
   2.9. Shykrane Zogaj,.....Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave,
   2.10. Sazan Cukaj,.....Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
   2.11. Zekë Tejeci,.....Drejtoria e Inspektorateve,
   2.12. Qendresa Racaj, ...Drejtoria e Shëndetësisë,
   2.13. Loreta Qollaku,.....Drejtoria e Administratës,
   2.14. Florentina Qoqaj.....Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor,
   2.15. Jakup Kastrati,.....Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,
   2.16. Kastriot Hoxhaj,.....Drejtoria e Tatimit në Pronë,
   2.17. Lulzim Sylejmani,.....Zyrtari Kryesor Financiar,
   2.18. Naim Kukaj,.....Zyra Ligjore,
   2.19. Laura Kelmendi Sela.....Zyra e Kryetarit të Komunës,
   2.20. Emine Gashi,.....zyrtare përgjegjëse për bashkëpunim me Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

3. Detyrat e Grupit Punues të emëruar si në pikën 2 të këtij Vendimi është që në afat sa më të shkurtër kohor, të hartojë Draft-Planin e Integritetit për Komunën e Prizrenit për periudhën 2027-2029, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Metodologjinë e Planit të Integritetit, të miratuar me Vendim nr. 1459/26, të datës 19.08.2026, të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit dhe akteve tjera nënligjore në fuqi dhe pas hartimit të draftit përkatës, ti procedohet organeve kompetente për shqyrtim dhe miratim.

4. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

5. Obligohet Grupi Punues për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Koordinatores së procesit,
- Anëtarëve të Grupit Punues,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 487/26 Dt. 21.10.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e mjeteve financiare për pagesë të ripërtëritjes së anëtarësimit të plotë në SCI—Washington International Affairs Institute LL.C të Komunës së Prizrenit

1. Me këtë Vendim lejohen mjetet financiare për pagesë të faturës të ripërtëritjes së anëtarësimit të plotës në SCI—Washington International Affairs Institute LL.C, të Komunës së Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim, lejohen mjetet financiare në shumën prej 2.249,00 $ (dymijë e dyqind e katërdhjetë e nëntë dollar).

2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

3. Pjesë përbërëse e vendimit është fatura e 2026F261003, të datës 6 tetor 2026.

4. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 496/26 Dt. 26.10.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092, Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik i plotësuar me rregulloren 002/2024 për prokurim publik, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për lejimin e ndryshimeve në projekt

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e ndryshimeve të pozicioneve (kolaudim të kontratës) në projektin: "Ndërtimi i aneksit të shkollës "Besim Nrecaj" Lutogllavë, i cili është duke u realizuar nga OE "Top Projekt" shpk, konform kontratës, nr. të prokurimit 622-23-1653-5-2-1.

2. Obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, menaxheri i kontratës, Sektori i Prokurimit, OE "Top Projekt", Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- OE "Top Projekt"
- Sektorit të Prokurimit,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 493/26 Dt. 26.10.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092, Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik i plotësuar me Rregulloren 002/2024 për Prokurim Publik, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për amendamentimin e kontratës

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për amendamentimin (ndryshimin) e kontratës për projektin: "Renovimi i shtëpisë së kulturës "Muharrem Samahodaj" në Krajk, me nr. 622-25-9188 -5-2-1, i cili është duke u realizuar nga OE –"AAB Construction" shpk.

2. Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit , Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
- Sektorit të Prokurimit,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 492/26 Dt. 26.10.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e realizimit të projektit: "Furnizim me kripë industriale" për mirëmbajtje dimërore të rrugëve të komunës së Prizrenit", kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.

2. Ky projekt realizohet sipas kodit buxhetor-mallra dhe shërbime të Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

3. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
- Sektorit të Prokurimit,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Beladiyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 495/26 Dt. 26.10.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 1 paragrafi 2, nenit 3 paragrafi 2 dhe nenit 14 paragrafi 1.2 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201, të datës 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës 01-400 nr. 121948, të datës 01.10.2026, të Ibrahim Thaqit, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për lejimin e mjeteve financiare

1. Miratohet kërkesa 01-400 nr. 121948, e datës 01.10.2026, të Ibrahim Thaqit, zyrtar publik në Drejtorinë e Administratës në Komunën e Prizrenit, për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të tij, i cili i është nënshtruar një ndërhyrjeje kirurgjike, kështu që, për këtë qëllim dhe në emër të mbulimit të pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit (trajtimit mjekësor), lejohen mjetet financiare në shumën prej 900.00 € (nëntëqind euro).

2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i subvencioneve dhe transfereve i Zyrës së Kryetarit të Komunës.

3. Obligohet Drejtoria e Administratës-Sektori Teknik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Drejtorisë së Administratës-Sektorit Teknik,
- Drejtorisë së Shëndetësisë,
- Të lartcekurit,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 491/26 Dt. 26.10.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera Nr-04-L-027, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për Themelimin e Shtabit Emergjent në Komunën e Prizrenit për gatishmëri emergjente lidhur me gjendjet e krijuara nga të reshurat atmosferike

1. Themelohet Shtabi Emergjent në Komunën e Prizrenit për gatishmëri emergjente lidhur me gjendjet e krijuara nga të reshurat atmosferike, në këtë përbërje:

   1.1. Shaqir Totaj,..... kryetar i Komunës, kryesues i Shtabit,
   1.2. Kujtim Gashi, ...nënkryetar i Komunës, zv. kryesues i Shtabit,
   1.3. Sead Arifi,.....drejtor i Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë,
   1.4. Islam Ukaj,.....drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
   1.5.Luljeta Veselaj Gutaj,.....drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
   1.6. Samra Ilijazi,.....drejtoreshë e Drejtorisë së Inspektorateve,
   1.7. Mybera Mustafa, ...drejtoreshë e Drejtorisë së Shëndetësisë,
   1.8. Nderim Kadriaj,.....drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,
   1.9. Nexhdet Mrasori,.....Komandant i Stacionit "Alfa",
   1.10. Bekim Gashi,..... drejtor i KRU-së "Hidroregjioni Jugor",
   1.11. Burim Shala,..... kryeshef ekzekutiv në KRM "Eko Regjioni".

2. Shtabi Emergjent në Komunën e Prizrenit për gatishmëri emergjente lidhur me gjendjet e krijuara nga të reshurat atmosferike, sipas pikës 1 të këtij vendimi, ka për detyrë të marrë të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e pasojave që vijë nga të këto të reshura atmosferike.

3. Shtabi sipas pikës 1 të këtij vendimi, sipas nevojës duhet të jetë i angazhuar 24 orë në ditë dhe të veproj në bazë të rrethanave dhe situatës së krijuar në komunë.

4. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi 01 nr. 610/25, i datës 18.11.2025.

5. Obligohet Shtabi Emergjent për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Shtabit Emergjent,
- Organeve tjera përkatëse,
- Zyrës për Marrëdhënie me Publikun,
- Arkivës së Kryetarit.